

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E MBROJTJES**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **217-26-3684-5-1-1**

Sa i përket tenderit për **Ndërtimi i kuzhinave ne Kazermat e FSK-së, e ndare ne dy Pjesë Pjesa 1 Ndërtimi i kuzhinave ne Shirokë-Suharekë Pjesa 2 Ndërtimi i kuzhinave ne Aeroportin e Gjakovës**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	N.T.P. " CATERING "
NUI	601086673
Adresa	Rrug B
Vendi	Prishtine
Kodi postar	10000
Numri Telefonit	
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Besnik Krasniqi
Adresa elektronike	niko22@hotmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	27.06.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Pjesa 1 Ndërtimi i kuzhinave ne Shirokë-Suharekë[[**Pjesa 2 Ndërtimi i kuzhinave ne Aeroportin e Gjakovës**

Ky aktivitet i prokurimit ka te beje me tenderin Ndërtimi i kuzhinave ne Kazermat e FSK-së, e ndare ne dy Pjesë Pjesa 1 Ndërtimi i kuzhinave ne Shirokë-Suharekë Pjesa 2 Ndërtimi i kuzhinave ne Aeroportin e Gjakovës me nr te prokurimit 2026/217-26-3684-5-1-1/B05-0009847

Njoftimi per kontrate eshte bere me daten 25.05.2026 eshte bere publikimi ne eprokurim Njoftimi per kontrate dhe afati i fundit per drozim te tenderit ka qene 10.07.2026 ne ora 14:00

Kriteri per dhenje te kontrates eshte: Cmimi me i Ulet

Me datën 16.06.2026 kemi dorezuar kerkes per rishqyrtim.

Me daten 18.06.2026 Autoriteti kontraktues ka mare vendim duke e Refuzuar si e pa bazuar kerkesen tone

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga

AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Pasi kemi analizuar Dosjen e Tenderit, te publikuar nga ana e AK, kemi vlerusuar se e njejta nuk eshte ne perputhje te plote me LPP dhe legjislacionin sekondare te prokurimit publike.

***Me date 16.06.2026 kemi parashtruar kerkes per rishqyrtim**

***Me date 18.06.2026 eshte nxejre vendimi per Refuzim si e pa bazuar kerksen tone per rishqyrtim.**

Duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e lartcekura dhe zhvillimet procedurale, konsiderojmë se janë cenuar të drejtat tona si palë e intereit për këtë procedurë të tenderimit, dhe si rrjedhojë jemi të detyruar të ushtrojmë të drejtën tonë ligjore përmes paraqitjes së kësaj ankese.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (LPP):

- Neni 1 (Qellimi);
- Neni 6 (Ekonomiciteti dhe Efikasiteti), paragrafi 6.1;
- Neni 7 (Barazia ne Trajtim/Jo-Diskriminimi), paragrafet 7.1-7.6;
- Neni 27 (Dosja e Tenderit), paragrafi 27.3;
- Neni 27/A (Ndarja e Kontratave në Lote), paragrafi 27/A.1;
- Neni 28 (Specifikimet Teknike), paragrafi 28.2.

Rregulla dhe Udhzuesi Operativ per Prokurimin Publik (RRUOPP), i ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024:

- Neni 4 (Administrimi i Pergjithshem i Procedurave të Prokurimit), paragrafi 4.3;
- Neni 13 (Parashikimi i Vleres dhe Klasifikimi i Kontrates), paragrafi 13.2;
- Neni 17 (Dosja e Tenderit), paragrafi 17.17;
- Neni 18 (Ndarja e Kontratave ne Lote), paragrafi 18.1.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

1. Klasifikimi i gabuar i aktivitetit si "kontratë e përzier" dhe

moskryerja e ndarjes në lote

Norma ligjore: Neni 6.1 i LPP-së obligon çdo autoritet kontraktues që fondet dhe burimet publike të përdoren "në mënyrën më ekonomike", duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

Nenet 7.2 dhe 7.3 të LPP-së ndalojnë ekzekutimin e çfarëdo aspekti të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton ose eliminon konkurrencën, përfshirë përmes mënyrës se si AK "ndan ose përmbledh sasi të ose artikujt" që duhet prokuruar. Neni 27/A.1 i LPP-së, si dhe nenet 13.2 dhe 18.1 të RRUOPP-së, autorizojnë dhe nxisin shprehimisht ndarjen e kontratave publike në lote homogjene ose heterogjene, pikërisht me qëllim të mundësisë të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë të specializuar "që janë në gjendje të furnizojnë vetëm pjesë specifike të mallrave, shërbimeve dhe punëve" (Neni 13.2 RRUOPP), duke i lënë OE të lirë "të zgjedhin për sa dhe cilat pjesë do të ofertojnë" (Neni 18.1 RRUOPP).

Fakti: Aktiviteti i prokurimit në fjalë përfshin njëkohësisht (i) punë ndërtimore dhe (ii) furnizim, instalim dhe mirëmbajtje të pajisjeve dhe inventarit të kuzhinës dy lëndë prokurimi qartazi heterogjene, që kërkojnë kapacitete teknike, profesionale dhe përvojë krejtësisht të ndryshme. Pavarësisht kësaj, AK e ka klasifikuar tërë aktivitetin si **kontratë të vetme "të përzier" dhe nuk e ka ndarë në lote.**

Lidhja shkak-pasojë: Bashkimi i dy lëndëve të ndryshme në një kontratë të vetme, pa arsyetim objektiv dhe pa vlerësim të mundësisë teknike/ekonomike të ndarjes, ka pasur efektin e drejtpërdrejtë të zvogëlimit të numrit të operatorëve ekonomikë të aftë të konkurrojnë: vetëm kompanitë ndërtimore me kapacitet edhe për furnizim dytësor mund të aplikojnë, ndërsa operatorët e specializuar në furnizim/instalim/servisim të pajisjeve të kuzhinës, si Operatori Ekonomik ankimues, mbeten të përjashtuar, edhe pse kjo është pikërisht veprimtaria e tyre kryesore. Kjo zvogëlon konkurrencën dhe, rrjedhimisht, cenon parimin e ekonomicitetit (Neni 6.1 LPP), pasi çmimi më i mirë për pajisjet e kuzhinës normalisht arrihet kur konkurrojnë drejtpërdrejt specialistët e fushës, jo nënkontraktorë të zgjedhur nga kompani ndërtimore pa interes të veçantë për të optimizuar këtë segment të kontratës.

Përfundim: Mosndarja në lote, në rrethanat konkrete të këtij aktiviteti, përbën shkelje të neneve 6.1 dhe 7.2/7.3 të LPP-së dhe injoron qëllimin e shprehur në nenet 27/A LPP, 13.2 dhe 18.1 RRUOPP. Kërkohej ndarja e aktivitetit në të paktën lote: (a) Lot - Punë Ndërtimi, dhe (b) Lot - Furnizim dhe Instalim i pajisjeve të Kuzhinës.

2. Dosja e tenderit dhe Fleta e të Dhënave të Tenderit (FTD), të përgatitura në mënyrë që favorizojnë kompanitë ndërtimore

Norma ligjore: Neni 7.6 i LPP-së obligon AK të sigurojë "pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomikë" dhe "eliminimin e praktikave, kritereve, kërkesave...që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomikë". Neni 17.17 i RRUOPP-së përcakton shprehimisht se dosja e tenderit duhet të përgatitet në mënyrë që: (a) nuk kufizon konkurrencën në mesin e OE, dhe (b) nuk diskriminon kundër ose në favor të një ose më shumë OE.

Fakti: Nga të gjitha kërkesat e parashtruara në FTD nën rubrikën "Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale", asnjë e vetme nuk lidhet me dëshmi përvojë në furnizim, instalim dhe mirëmbajtje të pajisjeve të kuzhinës kjo, edhe pse objektet që ndërtohen janë pikërisht kuzhina ku do të ushqehet personeli i Ministrisë së Mbrojtjes. Nuk është kërkuar asnjë certifikatë cilësie për pajisjet e kuzhinës, e as ndonjë dëshmi për punëtorë të kualifikuar për instalim/mirëmbajtje. Të gjitha kërkesat janë hartuar ekskluzivisht për profilin e kompanive ndërtimore.

Lidhja shkak-pasojë: Mungesa totale e ndonjë kriteri që do të lejonte vlerësimin e kapacitetit specifik për segmentin e pajisjeve të kuzhinës në një kontratë që e përfshin shprehimisht këtë furnizim nuk është neutrale: ajo e bën të pamundur që një OE specialist në këtë fushë (siç është Operatori Ekonomik ankimes) të dëshmojë avantazhin e tij konkurrues, ndërsa në të njëjtën kohë nuk vendos asnjë barrierë cilësore për këtë segment të furnizimit. Kjo asimetri e kriterëve favorizon në mënyrë të drejtpërdrejtë kompanitë ndërtimore dhe diskriminon kundër operatorëve të specializuar në pajisje kuzhine, në kundërshtim të hapur me ndalimin e Nenit 17.17(b) RRUOPP dhe me obligimin për pjesëmarrje sa më të gjerë nga Neni 7.6 LPP.

Përfundim: Kërkohet plotësimi i FTD-së me kërkesa proporcionale dhe relevante për kapacitetin teknik/profesional specifik për furnizim, instalim dhe mirëmbajtje të pajisjeve të kuzhinës, në nivel të barabartë me detajimin e kërkesave për punë ndërtimore - ose, në mënyrë më koherente, ndarja e aktivitetit në lote të veçanta sipas pikës 1 më lart, ku secili lot të ketë kriteret e veta, të përshtatura me lëndën përkatëse.

3. Specifikimet teknike diskriminuese: heshtje totale për pajisjet e kuzhinës

Norma ligjore: Neni 28.2 i LPP-së obligon AK të hartojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomikë, dhe e ndalon shprehimisht AK-në "të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomikë".

Fakti: Në dokumentin Specifikimet Teknike të Detyrueshme, AK nuk ka përshkruar asnjë fjalë lidhur me kërkesat teknike për pajisjet e kuzhinës, ndërkohë që për artikujt e tjerë (materiale dhe punë ndërtimi) i ka përshkruar mjaftueshëm në detaje. Po ashtu, nuk është kërkuar asnjë certifikatë për pajisjet e kuzhinës dhe inventarin, por vetëm për materialin dhe punën ndërtimore.

Lidhja shkak-pasojë: Heshtja totale e specifikimeve teknike për një kategori të tërë e substanciale të lëndës së kontratës krijon dy pasoja njëkohësisht të dëmshme: (i) operatorët e specializuar në pajisje kuzhine nuk kanë asnjë bazë të saktësuar mbi të cilën të përgatisin një ofertë të krahasueshme dhe konformuese, çka i vë në disavantazh konkurrues krahasuar me pjesën e punëve ndërtimore (që është përshkruar hollësisht); dhe (ii) AK heq dorë nga çdo mjet sigurimi të cilësisë

për këtë segment të furnizimit, duke rrezikuar vetë qëllimin e ekonomicitetit nga Neni 6.1 LPP, sepse pa specifikime dhe certifikata përkatëse nuk mund të garantohet që fondet publike të shpenzuara për pajisjet e kuzhinës të sjellin vlerën e duhur. Ky trajtim i pabarabartë i dy segmenteve të kontratës hollësi maksimale për punët ndërtimore, heshtje totale për pajisjet e kuzhinës përbën pikërisht atë favorizim ose diskriminim që Neni 28.2 LPP e ndalon shprehimisht.

Përfundim: Kërkohet hartimi i plotë i specifikimeve teknike dhe kërkesave për certifikim cilësie për pajisjet dhe inventarin e kuzhinës, në nivel detajimi të barasvlershëm me ato të vendosura për punët ndërtimore.

4. Përshkrimi i pajisjeve përmes kodeve/modeleve të një prodhuesi të caktuar (favorizim i markës/origjinës)

Norma ligjore: Neni 28.2 i LPP-së ndalon specifikimet teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë OE. Neni 7.4 i LPP-së ndalon krijimin e rrethanave që rezultojnë në "diskriminim territorial, fizik, material...ndërmjet operatorëve ekonomikë", ndërsa Neni 7.5 ndalon kushtëzimin që OE të furnizojë produkte "që rrjedhin nga një person, ndërmarrje ose rajon i veçantë gjeografik", përveç kur një kërkesë e tillë është shprehimisht e autorizuar me ligj.

Fakti: Në dokumentin e përshkrimit të çmimit, lista e pajisjeve të kuzhinës është paraqitur në gjuhën angleze, duke përdorur kodet dhe modelet e një prodhuesi të caktuar italian. AK nuk ka kërkuar deklarin e origjinës së pajisjeve të ofertuara, e as deklarin e prodhuesit dhe modelit në tabelën e përshkrimit të çmimeve.

Lidhja shkak-pasojë: Përshkrimi i lëndës së prokurimit përmes kodeve/modeleve specifike të një prodhuesi të vetëm pa shenjën standarde "ose ekuivalent" dhe pa ndonjë mekanizëm verifikimi (deklarim i detyrueshëm i prodhuesit/modelit/origjinës) e shndërron në fakt specifikimin teknik në një referencë të drejtpërdrejtë të marka, çka favorizon atë OE që mund të furnizojë ose përfaqësojë saktësisht këtë prodhues të caktuar italian dhe diskriminon të gjithë OE të tjerë që mund të ofrojnë pajisje teknike ekuivalente nga prodhues të ndryshëm. Kjo praktikë bie ndesh drejtpërdrejt me ndalimin e Nenit 28.2 LPP, dhe njëkohësisht krijon një formë diskriminimi sipas origjinës gjeografike/prodhuesit, e ndaluar nga nenet 7.4 dhe 7.5 të LPP-së. Mungesa e kërkesës për deklarim të prodhuesit/modelit/origjinës e bën gjithashtu të pamundur çfarëdo verifikimi objektiv të konformitetit të ofertave, duke cenuar transparencën e kërkuar nga Neni 7.1 LPP.

Përfundim: Kërkohet heqja e referencave specifike ndaj kodeve/modeleve të prodhuesit nga dokumentacioni teknik dhe i çmimeve, zëvendësimi me përshkrime të bazuara në funksion/performance (me shenjën "ose ekuivalent" kur referenca ndaj markës është e pashmangshme), si dhe shtimi i kërkesës për deklarim të detyrueshëm të prodhuesit, modelit dhe origjinës së pajisjeve të ofertuara, për qëllime verifikimi.

5. Përputhja e plotë e listës së pajisjeve me aktivitetin e prokurimit të vitit 2019 tregues i mungesës së vlerësimit real të nevojave

Norma ligjore: Neni 6.1 i LPP-së kërkon që AK të sigurojë përdorimin më ekonomik të fondeve publike "duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit" çka presupozon një vlerësim të mirëfilltë dhe specifik të nevojave aktuale të objektit konkret që po prokurohet, jo riprodhim mekanik të dokumentacionit nga aktivitete të mëparshme.

Fakti: Lista e pajisjeve të kuzhinës e përfshirë në dokumentin e përshkrimit të çmimit (Pajisjet dhe Inventari Elementet e Kuzhinës) është identike në renditje, përshkrim, dimenzione dhe sasi me listën e përdorur në aktivitetin e prokurimit të vitit 2019 "Ndërtimi i objekteve të ndryshme ushtarake", i ndarë në Pjesën 1 (Ndërtimi i objektit të Kuzhinës në Kazermën e FSK-së në Prishtinë) dhe Pjesën 2 (Ndërtimi i Aneksit të objektit të MKAB në Kazermën e FSK-së në Pomozotin), nr. 2019/217-19-5286-5-1-1/B05-0015649 pra për dy objekte krejtësisht të ndryshme nga ato të aktivitetit aktual.

Lidhja shkak-pasojë: Është teknikisht e pamundur që e njëjta listë pajisjesh, me të njëjtat dimensione dhe të njëjtën sasi, ti shërbejë në mënyrë adekuate nevojave konkrete dhe specifike të objektit/objekteve aktuale, aq më pak kur kjo listë origjinalisht ishte hartuar për dy objekte të ndryshme në një aktivitet prokurimi tjetër, të vitit 2019. Kjo përputhje e plotë tregon se dokumentacioni teknik i aktivitetit në fjalë mund të jetë kopjuar mekanikisht nga një aktivitet i mëparshëm, pa kryer vlerësimin real të nevojave specifike që kërkohet nga Neni 6.1 LPP, dhe paraqet rrezik konkret për probleme në ekzekutimin e kontratës (mospërputhje sasive/dimensioni me nevojat aktuale).

Përfundim: Kjo e forcon kërkesën e parashtruar në pikën 1: aktiviteti duhet ndarë në Kontratë për Punë dhe Kontratë për Furnizim me Pajisje të Kuzhinës, me një vlerësim të rifreskuar dhe specifik të nevojave sasiore për objektin aktual, e jo riprodhim të dokumentacionit nga aktivitete të mëparshme.

Bazuar në arsyetimin e mësipërm, Operatori Ekonomik ankimues i kërkon nga OSHP që:

1. Ta vlerësojë ankesën si të bazuar dhe ta pranojë në tërësi;
2. Të anulojë/pezullojë procedurën e aktivitetit të prokurimit në pjesët e kontestuara të dosjes së tenderit;
3. Të marrë vendim që obligon autoriteti kontraktues që këtë aktivitetet të prokurimit ta ndajë në të paktën dy lote/kontrata (a) Punë Ndërtimi, dhe (b) Furnizim, Instalim dhe Mirëmbajtje e Pajisjeve të Kuzhinës në përputhje me nenet 27/A LPP, 13.2 dhe 18.1 RRUOPP;
4. Të obligojë autoritetin kontraktues të plotësojë FTD-në dhe specifikimet teknike me kërkesa proporcionale, specifike dhe të detajuara për pajisjet e kuzhinës, në nivel të barasvlershëm me kërkesat për punë ndërtimore;

5. Të obligojë autoritetin kontratues heqjen e referencave ndaj kodeve/modeleve të një prodhuesi specifik dhe zëvendësimin e tyre me specifikime të bazuara në funksion/performance, së bashku me kërkesën për deklaram të prodhuesit, modelit dhe origjinës së pajisjeve të ofertuara;

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale që na shkaktohen nëse ne nuk na mundesohet pjesamaja ne këte aktivitet te prokurimite janë të konsiderueshme si në fushën financiare, fitime të munguara, dhe mos mundësi e kompensimit të shpenzimeve përgatitore për këtë kontratë.

Neve si Ofertues në këtë aktivitet të prokurimit kemi shpenzime të konsiderueshme për rishqyrtim në AK në përgatitjen e dokumentacionit (ofertës) dhe pjesëve të tjera të cilat ndërlidhen me këtë procedurë të prokurimit si: shpenzimet për përgatitjen e ankesave si në fazën e parë përfaqësimeve të cilat ndodhin etj.

Dëmi reflekton në dëmin material dhe jo-material e i cili shtrihet edhe në raport neni 136 dhe Neni 137 të LMD-së duke mos u kufizuar edhe në dëmin e imazhit dhe pasojave të tjera që në këtë fazë nuk janë në tërësi të konkretizuara.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*